



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.732/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Lirije Maksutaj, e me procesmbajtësen Kaltrina Çitaku Catilu, në konfliktin administrativ të paditësit, H.A., nga P., rr. "I.K.", nr.... kundër të paditurës, Kompania Kosovare për D. dhe F. me E.E.-K. sh.a. Divizioni i F. në P., për shkak të anulimit të përgjigjes, jashtë seance, me dt.26.09.2017, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, H.A., ndërsa Anulohet përgjigja e dt.14.11.2012, e të paditurës Kompania Kosovare për D. dhe F. me E.E.-K. sh.a. Divizioni i F. dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

II. Obligohet e paditura K. sh.a. Divizioni i F. nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

A r s y e t i m

Paditësi H.A., ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me dt.15.05.2014, kundër të paditurës, Kompania Kosovare për D. dhe F. me E.E.-K. sh.a. Divizioni i F., me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj padinë si të pabazuar dhe anulohet përgjigja e të paditurës të dt.14.11.2012, si e kundërligjshme.

Me përgjigjen e lëshura nga e paditura me dt.14.11.2012, ankuesit/konsumatorit i është refuzaur ankesa si pabazuar me konstatimin për arsyet e paraqitura si në arsyetimin e të njëjtës.

Paditësi i pakënaqur me përgjigjen i është drejtuar kësaj Gjykate me padi, duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtës.

Gjykata shqyrtoi aktin e goditur me padi, në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se, *“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen”*.

Po ashtu edhe në bazë të nenit 44.2 të të njëjtit ligj i cili përcakton se *“Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare”*.

Nga akti i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë datës. 29.08.2011, që konsistojnë në faktin se me nenin 10 par. 3 të kësaj rregulle është paraparë se: “në të gjitha rastet që nuk përfshihen në nenin 10 par. 2, furnizuesi do të përgjigjet me shkrim parashtruesit të ankesës dhe ajo përgjigje do të përmbajë: 3.1. emrin, shifrën, dhe adresën e konsumatorit, 3.2. arsyetimin dhe bazën ligjore, 3.3. proceset alternative për zgjidhjen e ankesave, nëse konsiderohet e përshtatëshme për rrethanat e ankuesit, 3.4. statusin e ankuesit, përfshirë çdo vendim dhe arsyetim për vendimin e lëshuar nëse është marrë me një vendim ose kërkesë për informacion shtesë ose veprim tjetër të kërkuar që do të shpejtonte procesin e zgjidhjes së kontestit, 3.5. këshillen juridike për konsumatorin mbi të drejtën e tij për të parashtruar ankesë në ZRRE, kundër përgjigjes së dhënë nga furnizuesi”.

Nga akti i kundërshtuar, gjykata vëren se, të njëjtit i mungojnë elementet esenciale të paraqitura më lartë e të cilat janë të përcaktuara me nenin 10 par. 3 të kësaj rregulle dhe të detyrueshme për organin e paditur, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së konsumatorit dhe dhënjes se një përgjigje sikur në rastin konkret.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se, organi i paditur, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së konsumatorit, tani paditësit, H.A., nuk ka vepruar në bazë të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë e dt.29.08.2011, respektivisht nenit 10 par. 3, duke e lëshuar një akt, i cili nuk përmban elementet esenciale të përmendura në nenin e cituar më lartë e i cili ka qenë i obliguar që të respektojë dispozitat e përcaktuara, e që në kundërshtim me këtë rregullë e ka lëshuar përgjigjen e datës. 14.11.2014.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar prandaj në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që konform nenit 65 të LKA-së, “*Kur gjykata anulon aktin kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar dhe në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër akt dhe jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi*”.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të neneve 5, 35, lidhur me nenin 44.2, të Ligjit për konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.732/14 dt.26.09.2017

Sekretare Juridike
Kaltrina Citaku

G j y q t a r e
Lirije Maksutaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.